



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr.

1416

Prishtinë,

Dt. 16/06/2026

**RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNITIT TE DIPLOMES
MASTER**

FAKULTETI	FSHMN-e
Departamenti/ Programi	Kimi/Msc.Kimi Organike
Projektpropozimi	Sinteza e sistemeve tetraciklike kromeno-pirimido-pirazol dhe aktiviteti antiproliferativ i tyre
Kandidati	Gresa Krasniqi
Mentori	Prof.Sevdije Govori Odai
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 26.02.2026, Këshilli i Fakultetit në mbledhjen e XXVI-te
	Vendimi nr.:566
Vlerësimi i dorëshkrimit Punimi i diplomes master i kandidates Gresa Krasniqi me titull " Sinteza e sistemeve tetraciklike kromeno-pirimido-pirazol dhe aktiviteti antiproliferativ i tyre" është shkruar në 51 faqe tekst të cilat përmbajnë 8 figura, 5 diagrame, 2 tabela, 8 skema të reaksioneve. Dorëshkrimi është organizuar duke filluar nga hyrja ku kandidatja përmes të dhënave nga literatura e konsultuar arsyeton qëllimin e temës së realizuar. Në pjesën eksperimentale janë përshkruar metodat e aplikuara të sintezës organike (metoda me refluktim dhe metoda me rrezatim mikrovalor) si dhe kushtet e zhvillimit të reaksioneve. Rezultatet e fituara janë diskutuar dhe në bazë tyre kandidatja ka arritur në përfundime. Gjatë përgatitjes së dorëshkrimit kandidatja ka konsultuar literaturë bashkohore gjithësejt 32 referenca të paraqitura në fund të dorëshkrimit.	

Analiza e dorëshkrimit

Dorëshkrimi me titull "Sinteza e sistemeve tetraciklike kromeno-pirimido-pirazol dhe aktiviteti antiproliferativ i tyre" i kandidates Gresa Krasniqi paraqet hulumtim shkencor bashkëkohor dhe me rëndësi në sintezë organike dhe aplikimin e komponimeve heterociklike bioaktive në mjekësi.

Kandidatja ka sintetizuar komponimet në vijim:

7-imino-6a,7,9,12a-tetrahidro-6H-kromeno[4,3-d]pirazolo[1,5-a]pirimidin-6-on;

7-imino-6-okso-6a,7,9,12a-tetrahidro-6H-kromeno[4,3-d]pirazolo[1,5-a]pirimidin-11-acid karboksilik;

7-imino-6-okso-6a,7,9,12a-tetrahidro-6H-kromeno[4,3-d]pirazolo[1,5-a]pirimidin-11-karbonitril;

11-hidroksi-7-imino-6a,7,9,12a-tetrahidro-6H-kromeno[4,3-d]pirazolo[1,5-a]pirimidin-6-on;

4-((3-metil-1-fenil-1H-pirazol-5-yl)amino)-2-okso-2H-kromeno-3-karbonitrile;

11-etil-7-imino-6a,7,9,12a-tetrahidro-6H-kromeno[4,3-d]pirazolo[1,5-a]pirimidin-6-on;

Komponimet janë sintetizuar gjatë refluktimit të përzierjes së reaksionit janë monitoruar me KSHH (TLC). Të njëjtat komponime janë sintetizuar edhe me metodën mikrovalore dhe janë evidentuar ndryshimet në kohën e zhvillimit të reaksioneve dhe rendimentet e produkteve.

Struktura e komponimeve të fituara është përcaktuar me analiza spektroskopike: IK, ^1H -RBM dhe ^{13}C -RBM.

Komponimet e sintetizuara janë testuar në tre linja qelizore tumoriale: MCF-7 (adenokarcinoma e gjirit, ATCC® HTB-22™), HCT116 (karcinoma kolorektale ATCC® CCL-247™) dhe NCI-H460 (karcinoma e mushkërive, kanceri i mushkërive me qeliza të mëdha (ATCC® HTB-177™).

Nga testimi ka rezultuar se aktiviteti i komponimeve të sintetizuara është përgjithësisht i moderuar dhe varet kryesisht nga përqendrimi i mostrave të përgatitura nga komponimet e përfituara, në rastin konkret përqendrimi më i lartë i mostrës së testuar (100 μM). Një aktivitet disi më i spikatur dhe selektiv është demonstruar nga komponimi i katërt, dmth tregon aktivitet të rëndësishëm ndaj linjave qelizore HCT 116 dhe MCF-7, ndërsa ishte më pak aktiv ndaj qelizave H460.

Nga kjo rezulton se komponimet heterociklike të sintetizuara dëshmojnë potencialin e tyre si molekula premtuese për zhvillimin e agjentëve të rinj antikancerogjenë.

Përfundim dhe propozim

Pas shqyrtimit të dorëshkrimit me titull: "Sinteza e sistemeve tetraciklike kromeno-pirimido-pirazol dhe aktiviteti antiproliferativ i tyre" të kandidatës Gresa Krasniqi, konsiderojmë se metodat e përdorura gjatë punës eksperimentale, interpretimi spektroskopik i strukturave të komponimeve të sintetizuara dhe testimi biologjik i tyre, paraqesin kontribut në fushën e sintezës organike. Bazuar në atë që u tha më lart rekomandojmë procedimin e më tutjeshëm të dorëshkrimit të temës së master.

Prishtinë, 10.06.2026

Komisioni:

1. Prof. Majlinda Daci- kryetare

M Daci

2. Prof. Sevdije Govori-anëtare

Govori

3. Prof. Arben Haziri- anëtare

Arben Haziri